



**Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

## **Rregullore e Licencimit Nr. 01/2012**

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i Rregullores është që përmes rregullave të përcaktuara në këtë Rregullore, ARH-ja të paraqesë procedurat dhe kriteret që duhet të përmbushën në procesin e aplikimit për licencë, në mënyrë që procesi të jetë i qartë dhe transparent.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

Kjo Rregullore është për operatorët momental dhe ata të ardhshëm të cilët ofrojnë shërbime:

- Shërbimeve për pasagjerë dhe mallra,
- Shërbime të kombinuara për pasagjerë dhe mallra,
- Mirëmbajtje të makinave tërheqëse dhe makinave tjera që kanë të bëjnë me hekurudhat,
- Rrjetet,
- Stacionet dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacione ranzhiruese),
- Depot e mirëmbajtjes së makinave dhe
- Asete tjera të mirëmbajtjes
- Si dhe ndonjë kombinim i të lartcekurave.

Rregullorja në fjalë do t'ju ndihmojë të dorëzoni një aplikacion të plotë me dëshmi tjera mbështetëse. Kjo do të na ndihmojë gjithashtu neve në procedimin e aplikacionit tuaj në mënyrën e duhur. Kur nuk i zbatoni procedurat tona apo nuk na lini kohë të mjaftueshme, nuk do të kemi mundësi t'ju lëshojmë licencën para datës që keni planifikuar të filloni punën.

Këtu gjithashtu paraqiten obligimet tuaja të vazhdueshme. Ne mbulojmë vetëm çështjet e licencimit këtu. Pika 4 "kompetenca e sigurisë" e formularit të aplikacionit është vetëm për natyrën informative. Pra, ju duhet të shqyrtoni gjëra tjera sikurse obligimet për shëndetin dhe sigurinë dhe marrëveshjet për qasje para se të filloni me operimin.

**Ne inkurajojmë të gjithë ata që kanë nevojë për licencë të diskutojnë propozimet e tyre me ne para se të parashtrijnë një aplikacion në mënyrë zyrtare.**

Operimi me hekurudha dhe asetet e hekurudhave pa një licencë adekuate do të konsiderohet e kundërligjshme bazuar në Ligjin e Hekurudhave. Ju duhet të vazhdoni t'u përmbaheni kushteve përkatëse të licencës si dhe kriterëve tjera autorizuese kur licenca ju është lëshuar.

## **Neni 3 Organi i Licencimit**

ARH është organi i pavarur përgjegjës për licencim në sektorin hekurudhor të Kosovës. Për më shumë informacione, ju lutem shikoni **ueb faqen tonë**.

## **Neni 4 Operatori**

Operatori mund të jetë një individ, një kompani apo disa forma tjera të organizimit. Për qëllime licencimi duhet të ketë personalitet juridik të dallueshëm. Pra një divizion apo individ brenda një kompanie nuk mund të jetë operator. Licencat nuk mund të mbahen normalisht në nivel grupi për kompanitë tjera apo kompani pjesë të atij grupi. Operatori mund të jetë i ndryshëm nga pronari.

## **Neni 5 Llojet e Licencave në Kosovë**

Ne lëshojmë llojet e licencave në vijim për operim në Kosovë:

- Licencat për shërbime për pasagjerë (Lloji A)
- Licencat për shërbime transporti për mallra (Lloji B)
- Licencat për shërbime të kombinuara për pasagjerë dhe mallra (Lloji C=A+B)
- Licencat për makina të mirëmbajtjes, makina tjera speciale që kanë të bëjnë me hekurudhat (Lloji D)
- Licencat për operimin e rrjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës hekurudhore (Lloji I)
- Licencat për stacione dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacione ranzhiruese) (Lloji S)
- Licencat për depot e mirëmbajtjes së makinave dhe asete tjera të mirëmbajtjes (Lloji M)
- Licencat për ndonjë operacion të kombinuar të rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore, stacionet dhe терминалет, depot e mirëmbajtjes për makinat dhe asete tjera të mirëmbajtjes (Lloji I+S)

## **Neni 6 Fushëveprimi i licencave**

Licencat autorizojnë operimin kudo në Kosovë vetëm nëse certifikata përkatëse e sigurisë dhe/apo autorizimi i sigurisë janë marrë.

## **Neni 7 Licencat e huaja të vlefshme në Kosovë**

1. Licencat e vlefshme të lëshuara për operim hekurudhor nga ndonjë organ licencues i Bashkimit Evropian, Pjesëmarrësit e SEETO-s (nënshkruesit e Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit), dhe organeve të tjera të huaja licencuese do të jenë të vlefshme në Kosovë nëse janë në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

2. Pas pranimit të licencës për shqyrtim, ARH e njofton mbajtësin e licencës dhe Ministrin brenda tridhjetë (30) ditësh nëse licenca është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

## **Neni 8 Kohëzgjatja e Licencës**

Licencat standarde zakonisht kanë një datë të caktuar skadimi apo janë valide derisa bëhet revokimi nga ne.

## **Neni 9 Përgatitja e aplikacionit**

Për të trajtuar një aplikacion në afatin e duhur kohor, ne dëshirojmë të finalizojmë procedurën e aplikimit brenda 3 muajsh. Kjo kërkon përkrahjen tuaj të plotë.

## **Neni 10 Formularët e aplikacionit për licencë**

1. Për aplikimin për licencë ju duhet të përdorni formular specifik të aplikimit që sigurohen nga ne. Ato mund të gjenden në ueb-faqen tonë. Këta formularë kërkojnë informacionet minimale të nevojshme për të filluar trajtimin e aplikacionit tuaj.

2. Ju duhet ta parashtroni atë në kopje fizike së bashku me dokumentacionin përcjellës. Ju gjithashtu mund t'i dërgoni me e-mail. Ne mund të kërkojmë më shumë informata kur aplikacioni është në proces të trajtimit. Është vepër e jashtëligjshme nëse para nesh bëhen deklaratime që e dini se janë të rrejshme, apo me pakujdesi të bëhet ndonjë deklaratë e cila është e rrejshme.

3. Ne do ta konfirmojmë marrjen e aplikacionit tuaj brenda 48 orëve, si dhe emrin e personit që është i angazhuar me rastin tuaj.

## **Neni 11 Procedura**

1. Ne mund të ngrisin ndonjë shqetësim të menjëhershëm në lidhje me aplikacionin, nëse paraqitet ndonjë.

2. Ne do të kontrollojmë aplikacionin tuaj se a është i plotë dhe për tu siguruar se kemi informatat e mjaftueshme. Atëherë do të marrim një vendim fillestar se a të pranohet apo jo aplikacioni. Nëse mendojmë se një aplikacion nuk duhet të pranohet, normalisht ne duhet t'ju japim edhe katër javë tjera kohë që të paraqitni qëndrimet tuaja para se të merret vendimi përfundimtar.

3. Rrallë ndodhë që ne të kthejmë aplikacionet në atë mënyrë, por një gjë e tillë mund të ndodhë. Arsyet mund të jenë se ju nuk ofroni informata të bollshme apo në rast se operimi juaj nuk do të fillojë brenda 9 muajsh pasi të keni marrë certifikatën e sigurisë dhe brenda 18 muajsh prej kur të keni marrë autorizimin e sigurisë.

## **Neni 12**

### **Përfshirjet e licencës**

Fillimisht ju duhet të kontrolloni nëse tashmë keni ndonjë përfshirje nga sistemi i licencimit. Nuk ekziston ndonjë tarifë për procesimin e kërkesave për përfshirje nga licenca. Ju lutem përfshini hartat apo planet e operacioneve tuaja nëse është e mundur.

## **Neni 13**

### **Bisedimet joformale**

1. Ne mirëpresim qasjet jo-formale në faza të hershme para aplikimit.
2. Ne mund të shpjegojmë kërkesat tona që duhet përmbushur, mund të ndihmojmë në identifikimin e çështjeve tjera rregullatorë dhe të diskutojmë afatet kohore. Edhe pse ne mund të japim udhëzime të hershme në mënyrë joformale, opinioni ynë mund të ndryshojë kur ne shqyrtojmë aplikacionin tuaj të parashtruar formalisht. Mirëpo udhëzimi në një fazë të hershme mund të jetë i vlefshëm, u kursen kohë dhe shpenzime.

## **Neni 14**

### **Konfidencialiteti**

1. Ne jemi të përkushtuar për të qenë të hapur dhe transparentë, mirëpo ne çojmë marrjen e informatave gjatë aplikimit të cilat janë të ndjeshme nga aspekti ekonomik. Ju duhet të kërkonit nga ne që të trajtojmë informatat e ndjeshme si “konfidenciale”. Ju lutem tregoni qartë kur kemi të bëjmë me një situatë të tillë.
2. Ne duhet të publikojmë informata të caktuara në lidhje me aplikuesit dhe operacionet e propozuara në ueb-faqen tonë gjatë fazës së konsultimeve statusore.

## **Neni 15**

### **Njoftimet**

1. Ne do të njoftojmë Ministrinë e Infrastrukturës kur të kemi marrë vendimin për lëshimin e licencës apo kur të kemi pranuar licencat e huaja.
2. Njoftimi do të publikohet në ueb faqen tonë. Gjithashtu kopjet do t’u dërgohen juve.

## **Neni 16**

### **Afatet kohore**

1. Neve na nevojitet kohë e mjaftueshme për të marrë një vendim të informuar mirë për secilin aplikacion. Nëse aplikacioni juaj nuk është i plotë dhe ju duhet të bëni më shumë punë në të, ju gjithashtu duhet të llogarisni kohë për atë. Për shembull neve do të na duhet të shqyrtojmë rregullimin tuaj të sigurimit para se t’ju lëshojmë një licencë. Ju zakonisht duhet të na jepni së

paku dymbëdhjetë javë ndërmjet kohës kur bëhet aplikimi për licencë dhe kur ju dëshironi të filloni me operacionet.

2. Gjatë këtij procesi të aplikimit ju gjithashtu duhet të provoni të merrni ndonjë miratim të domosdoshëm për sigurinë (p.sh. certifikatën apo autorizim e sigurisë), apo ndonjë leje tjetër (lejën për makinist, etj.). Ju duhet të jepni kohë më të gjatë nëse aplikacioni juaj është kompleks, nëse ngriten çështje të reja, apo ka të ngjarë të rezultojë në shqetësime që ngriten nga palët tjera.

3. Megjithatë ju lutem mos aplikoni tepër herët apo në baza spekulative pasi që situata mund të ndryshojë, apo ne mund të vendosim ta kthejmë aplikacionin tuaj. Afatet kohore mund të diskutohen me ne në një takim paraprak. Ne do të marrim një vendim në lidhje me atë nëse licenca mund të aprovohet brenda tre muajsh prej marrjes së të gjitha informatave që na nevojiten.

4. Ne nuk mund të lëshojmë licenca të përkohshme për të mbuluar operacionet gjatë procesit të aplikimit. Ju nuk mund të filloni operacionet derisa të jetë lëshuar licenca e nevojshme, madje edhe nëse keni marrë certifikatën apo autorizimin e sigurisë.

### **Neni 17** **Kriteret e licencimit**

1. Në të vendosurit nëse duhet dhënë licenca, ne duhet të jemi të kënaqur me atë që ju jeni “i përshtatshëm dhe i duhur”.

2. Nëse dëshironi një licencë, ju duhet të keni reputacion të mirë, duhet të jeni i përshtatshëm financiarisht, kompetent nga aspekti profesional dhe i siguruar në mënyrë adekuate. Të gjithë aplikuesit për licenca duhet të përmbushin këto kritere gjatë fazës së aplikimit në mënyrë që të marrin licencën.

3. Të licencuarit gjithashtu duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë zbatueshmërinë e duhur në vazhdimësi.

### **Neni 18** **Reputacioni i mirë**

1. Ne do t’ju miratojmë licencën nëse keni reputacion të mirë. Ju duhet të siguroni hollësi të ndonjë:

1.1 Urdhri për bankrotim (në Kosovë apo diku tjetër) që janë bërë kundër ndonjë zyrtari të kompanisë, ndonjë procedurë ligjore kundër zyrtarëve të kompanisë apo aksionarëve kryesor.

1.2 Prokuroritë apo urdhrat zbatues që janë ngritur nga përfaqësuesit shtetëror, gjykatat dhe autoritetet tjera shtetërore brenda dhe jashtë Kosovës, agjencitë mjedisore apo autoritetet lokale, dhe

1.3 Ndonjë shkelje e ligjeve të doganave.

2. Ne gjithashtu bëjmë hetimet tona me organet apo agjencitë tjera ose kërkojmë nga ju informata të mëtejme. Një deklaratë nën këtë kaptinë nuk nënkupton domosdoshmërisht që ne nuk do t’ju japim licencën.

## **Neni 19**

### **Përshtatshmëria financiare**

1. Ju do të plotësoni standardin e kërkuar të përshtatshmërisë financiare kur ju demonstroi se ju do të jeni në gjendje të plotësoni obligimet aktuale dhe ato të ardhshme, përcaktuar sipas supozimeve reale për dymbëdhjetë muajt në vijim.
2. Ne nuk japim licenca ku një aplikues ka vonesë të madhe në pagesa dhe në tatime apo në pagesa sociale. Në shqyrtimin e informatave që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë financiare që ju ofroni, ne nuk dëshmojmë ndonjë formë të sigurisë në të cilën mund të mbështetet pala e tretë për ndonjë qëllim.

## **Neni 20**

### **Kompetenca profesionale dhe e sigurisë**

Ne do të konsiderojmë se jeni profesionalisht të aftë nëse ne jemi të kënaqur që ju plotësoni të gjitha kërkesat e duhura për ligjet që kanë të bëjnë me shëndet dhe siguri të cilat nuk janë të specifikuara në ligjin për hekurudha. Ne zakonisht nuk bëjmë ndonjë kërkesë shtesë si kushte licencimi. Për të shmangur keqkuptimin, organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore ka të bëjë me çështjet e sigurisë hekurudhore.

## **Neni 21**

### **Sigurimi**

1. **Ju duhet të siguroheni në mënyrë adekuate apo të bëni aranzhimet ekuivalente për mbulim, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, të përgjegjësive tuaja në rast të aksidentimit të pasagjerëve, bagazhit, mallrave, postës dhe palëve të treta.**
2. Sigurimi llogaritet si adekuat nëse është miratuar nga ne. Prandaj ju do të plotësoni këtë kriter nëse ju u përmbaheni kushteve për përfitimin dhe mirëmbajtjen e sigurimit të përgjegjësive të palës së tretë siç shpjegohet në aneks “Udhëzimet për operatorët në lidhje me kushtet e sigurimit të përgjegjësive të palës së tretë”.

## **Neni 22**

### **Ndryshimi i kontrollit**

1. Ju duhet të na tregoni neve në lidhje me ndonjë ndryshim të kontrollit në kompaninë tuaj. Kjo kaptinë mbulon procedurat për të ndjekur në ato rrethana. Ky udhëzim ndërlidhet vetëm me çështjet e licencimit.
2. Kur të drejtat e një personi, aksionari direkt apo indirekt për të votuar, tek një mbajtës i licencës rritet për më shumë se 25 % të operatorit, në Kosovë, kjo normalisht do të jetë ndryshim i kontrollit. Ky rast ka ndikim në licencë dhe si rrjedhojë duhet informuar neve.

3. Një ndryshim kontrolli në një kompani që tashmë është e licencuar nuk nënkupton që një licencë e re duhet të lëshohet. Kjo është për shkak se identiteti ligjor i kompanisë do të mbetet i njëjti, madje edhe nëse pronarët kanë ndryshuar. Sidoqoftë ndryshimet mund të jenë fuqiplota me mundësinë e operatorit për të përmbushur obligimet e veta në mënyrën e duhur. Kështu që informatat e kërkuara në rast të ndryshimit të kontrollit janë të ngjashme me ato që kërkohen për aplikuesit e rinj.

4. Ju duhet të na informoni me shkrim sa më shpejt që është e mundur pas çdo ndryshimi të kontrollit. Është e mundur që ndryshimi i kontrollit do të mund të ndikonte në përshtatshmërinë e operatorit për të vazhduar të jetë i autorizuar.

5. Ne mund të revokojmë një licencë nëse dikush që ne kundërshtojmë mbetet në kontroll të një operatori apo ndikon në mundësinë për t'iu përmbajtur kushteve të licencës.

## Neni 23

### Përshtatja para ndryshimit të kontrollit

1. Kushdo që dëshiron të marr kontrollin tuaj, duhet që para se të bëhet ndarja e aksioneve të aplikojë për **letrën e përshtatjes** nga ne në mënyrë që të jetë e mundshme që veprimet rregullative të jenë në përputhje me blerjen e propozuar. Aplikuesi që normalisht do të jetë personi i cili kërkon të marrë kontrollin duhet të plotësojë aplikacionin pa pagesë dhe duhet ta dorëzojë së paku tetë javë para datës së përvetësimit të kontrollit.

2. Ne do të vlerësojmë nëse aplikuesi është person i përshtatshëm dhe i duhur për të qenë në kontroll të operatorit të licencuar, duke u bazuar në informatat e ofruara. Aplikacioni do të përshpejtohet nëse fillimisht na thuhet se nuk ka plane apo qëllim për ndryshim të natyrës së operacioneve të bartësit të licencës. Një formë e kënaqshme e fjalëve do të ishte: 'prej kohës së tillë si {aplikuesi} të marrë kontrollin e {bartësit të licencës}, unë konfirmoj në emër të {aplikuesit} që asnjë ndryshim material nuk do të bëhet në strukturë dhe operim të {bartësit të licencës}.'

3. Më tej aplikuesi duhet të konfirmojë aty ku është e mundur që ndryshimi i propozuar i kontrollit nuk do të kishte ndonjë ndikim negativ në aftësinë e bartësit të licencës për të përmbushur obligimet e veta të përgjegjësisë së sigurimit për palën e tretë. Aplikuesi gjithashtu duhet të konfirmojë që bartësi i licencës do t'i përmbahet miratimit të përgjithshëm për sigurimin e përgjegjësisë për palën e tretë apo ndonjë obligim tjetër të sigurimi të përcaktuar nga ne.

4. Nëse aplikuesi demonstroi se është i përshtatshëm dhe i duhur për të qenë në kontroll të operatorit të licencuar, atëherë ne mund të ofrojmë një letër të përshtatshmërisë ku theksohet se ne kemi shqyrtuar informatat e ofruara dhe në ato baza do të vendosim për miratimin e ndryshimit të propozuar të kontrollit. Ky indikacion nuk është detyrues, pasi që ndonjë vendim zyrtar do të merret duke u bazuar në të gjitha informatat që ne kemi në dispozicion pasi ndryshimi i kontrollit të jetë kryer.



## **Neni 24**

### **Njoftimi zyrtare**

1. Pas ndryshimit të kontrollit, bartësi i licencës duhet të na njoftojë me shkrim sa më shpejt që është e mundur pasi të jetë kryer ndryshimi i kontrollit. Kjo duhet të përfshijë përqindjen apo fraksionin e aksioneve që pronari i ri ka përvetësuar dhe datën kur kjo ka ndodhur, aty ku është relevante.
2. Nëse emri i kompanisë së regjistruar apo adresa ka ndryshuar si rezultat i ndryshimit të kontrollit, kjo gjithashtu duhet të theksohet. Këto informata do të na ndihmojnë në freskimin e të dhënave tona dhe regjistrin publik.
3. Ne do të vlerësojmë ndonjë ndryshim të lajmëruar të kontrollit duke u bazuar në të gjitha informatat që kemi në dispozicion duke përfshirë kërkesat e parashtruara për letër përshtatshmërie. Vlerësimi ynë mund të marrë kohë deri në tetë javë por zakonisht do të jetë më i shpejt kur një letër përshtatshmërie tashmë të jetë lëshuar dhe nuk ka ndryshim në rrethana. Nëse ne vendosim që të mos aprovojmë ndryshimet, ne do t'ju tregojmë juve dhe shqyrtojmë ndonjë përfaqësim. Nëse ende nuk jemi të kënaqur që ndryshimi i kontrollit duhet miratuar, ne do të revokojmë licencën bazuar në procedurat ligjore.

## **Neni 25**

### **Konfidencialiteti**

1. Ne respektojmë që shumë kërkesa për letra përshtatshmërie dhe njoftime për ndryshim kontrolli mund të përmbajnë informata të ndjeshme komerciale. Ju lutem tregoni qartë kur ndonjë informatë dërgohet nën konfidencialitet. Ne zakonisht nuk i diskutojmë këto raste, dhe letrat e përshtatshmërisë në veçanti, me palët e treta. Por të keni parasysh se ne zakonisht presim këmbimin e informatave të caktuara relevante me rregullatorë tjerë aty ku nevojitet.
2. Ne mund të vendosim informata në regjistrin tonë publik pas ndryshimit të kontrollit, sikurse letrat nga ne. Megjithatë, ne nuk postojmë ndonjë dokument që ndërlidhet me letrat e përshtatshmërisë.

## **Neni 26**

### **Monitorimi dhe zbatimi**

1. Bartësit e licencave duhet përmbajtur kushteve që ndërlidhen me licencat e tyre gjatë gjithë kohës. Në veçanti ata duhet të përmbushin katër kriteret e licencimit që paraqiten në Kaptinën 4. Nëse ekzistojnë dyshime serioze në lidhje me atë se a u përmbaheni ndonjërit prej këtyre kriterëve, ne mund të bëjmë hulumtime të mëtejme. Nëse licenca juaj është aprovuar nga ndonjë tjetër organ e jo nga ne, ne do t'i njoftojmë ata.
2. Mos përmbajtja me të gjitha kushtet e licencës që janë relevante me ju, mund të rezultojë në veprim zbatimi dhe hetime nga ana jonë.

3. Më tej konsiderohet si shkelje nëse zhvillohen operacione hekurudhore pa pasur licencë, madje edhe nëse keni certifikatën e sigurisë apo autorizimin e sigurisë. Ju mund të ndiqeni apo hetoheni nëse bëni një gjë të tillë.

### **Neni 27** **Monitorimi i sigurimit**

1. Sipas rastit, ne mund të kontrollojmë operatorët individual apo një mostër të operatorëve për tu siguruar se mbulimi me sigurim është adekuat, madje edhe kur të jenë ofruar letrat ndërmjetësuese. Ju duhet të mirëmbani shënimet në lidhje me atë se si aranzhimet tuaja të sigurimit përmbushin kushtet e miratimit të përgjithshëm. Prandaj ju duhet të mbani kopjet e të gjitha sigurimeve, policat, dokumentet dhe certifikatat. Ju duhet t'i kërkonit këto nga ndërmjetësuesit tuaj nëse ato nuk ju kanë dërguar automatikisht. **Ne mund të kërkojmë nga ju në çdo kohë që të sillni kopjet e këtij dokumentacioni. Ju duhet t'i sillni ato pa vonesë.**

2. Kontrolli ynë do të mund të përfshinte: një vlerësim i bazuar në rrezik mund të kryhet nga ne se cilët operatorë do të auditohen, përzgjedhja sipas rasisjes, dhe ndonjë ngjarje që ndodh, sikurse njoftimi i anulimit që mund të lëshohet apo shqetësime tjera sikurse përshtatshmëria financiare, ankesat, raportet e shtypit, informatat e pranuar (nga ndërmjetësuesit dhe të tjerët).

3. Ju nuk guxoni të operoni me asetet e hekurudhës nëse nuk keni të aprovuar sigurimin e duhur nga ne. Nëse dëshironi të mbani një licencë derisa nuk operoni për një periudhë të shkurtër kohore dhe pa sigurim adekuatë, atëherë ju duhet të aplikoni tek ne paraprakisht për një ndryshim të tillë.

### **Neni 28** **Monitorimi i përshtatshmërisë financiare**

1. Të licencuarit konsiderohet se i përmbushin standardet e përshtatshmërisë financiare nëse ata mund të demonstrojnë që ata mund të kryejnë obligimet aktuale dhe ato të ardhshme, që konstatohet sipas supozimeve realiste për një periudhë prej dymbëdhjetë muajsh.

2. Megjithatë, nën kurrfarë rrethanash ne nuk ofrojmë ndonjë formë të sigurisë në të cilën palët e treta mund të mbështeten për çfarëdo qëllimi. Ju duhet të mbani shënimet që demonstrojnë përshtatshmërinë tuaj financiare të vazhdueshme.

3. Ne do të revokojmë ndonjë licencë, në rrethana të caktuara nëse janë filluar procedura për të likuiduar kompaninë apo nëse një aplikacion është bërë për urdhër të administrimit hekurudhor mbi bazat që operatori nuk mund të paguajë borxhet e veta. **Në disa raste** ne mund të lëshojmë licenca të përkohshme.

### **Neni 29** **K kontrolli i kompetencës profesionale**

Ju normalisht do të konsideroheni profesionalisht kompetent nëse ne jemi të kënaqur që ju keni një organizim menaxhues që posedon njohuritë apo përvojën e nevojshme për të ushtruar operacione të sigurt dhe të besueshme. Nëse marrim dëshmi se ju nuk keni të gjitha autorizimet relevante të sigurisë, apo ndryshe nuk jeni duke iu përmbajtur ligjit të shëndetit dhe sigurisë, ne

mund të hetojmë nëse ju duhet të vazhdoni të mbani licencën. Kjo më tej do të ishte ndonjë veprim tjetër i ndërmarrë nga ne nën legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.

### **Neni 30** **Sigurimi i reputacionit të mirë**

Ne presim që bartësit e licencës të vazhdojnë të mbajnë reputacionin e mirë. Ne do të hulumtojmë ndonjë shqetësim apo ankesë, në bazë të meritave të tyre dhe konformë legjislacionit.

### **Neni 31** **Zbatimi**

1. Ne jemi **kompetent** për zbatimin e kushteve të licencimit dhe për të hetuar përmbajtjen e kriterëve të licencimit, pasi që qëllimi i zbatimit të licencës është të sigurojë kryerjen dhe sigurimin e përputhjes me obligimet e interesit publik.

2. Nëse nuk veproni në përputhje me obligimet e licencës ne do të shqyrtojmë veprimet zbatuese. Kjo përfundimisht mund të rezultojë në pezullim apo revokim të licencës suaj.

### **Neni 32** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të sajë.

---

Halit Gara,  
Kryesues i Bordit të ARH-së.

Prishtinë, 22.06.2012.

## ANEKS I

### 'Udhëzime për operatorët në lidhje me kushtet e sigurimit'

#### 1. Dispozitat e përgjithshme

Të gjithë operatorët e licencuar duhet të bartin dhe mirëmbajnë **sigurimin** e duhur, sipas kushteve të miratuara nga ne.

#### 2. Sigurimi

##### 2.1 Kërkesat e përgjithshme

Ne duhet të miratojmë aranzhimet tuaja të sigurimit para se licenca juaj miratohet, ose në disa raste ndonjë përjashtim licence. Në veçanti aranzhimet e sigurimit të palës së tretë janë të rëndësishme tejet të veçantë për miratimin e licencës suaj pasi që edhe hekurudhat si dhe mënyrat e transportimit mund të shkaktojnë lëndime trupore apo dëmtim ose shkatërrim të pronës së individëve përveç atyre që janë të siguruar apo siguresve.

##### 2.2 Fushëveprimi i policave

Përveç sigurimeve tjera të kërkuara nga ligjet në Kosovë, ju duhet të keni dhe të mirëmbani sigurimin për rreziqet e palëve të treta të cilat u mbulojnë juve, punëtorët, dhe ndonjë person tjetër "të tretë" që shprehimisht kërkohet të jetë i përfshirë si i siguruar, sa u përket detyrimeve ligjore të cilat mund të shkaktohen në lidhje me vdekjen apo lëndimet trupore të ndonjë personi dhe humbje apo dëmtim të pronës që rrjedhin nga veprimtaritë e licencuara.

##### 2.3 Miratimi i përgjithshëm

Kur të kemi miratuar licencën tuaj, miratimi i sigurimit tonë të përgjithshëm do të vlejë për ju. Mos-përmbushja e kushteve të miratimit të përgjithshëm do të mund të rezultojë në veprime zbatuese. Për të demonstruar aranzhimet adekuate të sigurimit, policat tuaja duhet të përmbushin kërkesat sipas miratimit të përgjithshëm.

Në këtë kontekst pikat tjera për tu shqyrtuar përfshijnë:

- Ju duhet të keni pritje të arsyeshme për të plotësuar **detyrimet tuaja vetë-sigurese**.
- Sigurimi duhet të merret nga siguresit e rregullt me reputacion të mirë.
- Mbulimi me sigurim duhet aplikuar gjatë gjithë kohës kur operacionet ndërmerren.
- Policat e sigurimit mund të përmbajnë klauzola në lidhje me të drejtat për të anuluar apo për të ndryshuar kushtet. Por secila policë duhet të kërkojë së paku 30 ditë njoftim për ne nga siguresi për ndonjë gabim, për ndonjë anulim apo ndryshim të rëndësishëm në policë.

Obligimi për të pasur mbulueshmërinë sa herë që operacionet ndërmerren, nënkupton policat e sigurimit nuk duhet të përmbajnë klauzola që lejojnë siguresin t'u shmanget obligimeve të veta në retrospektivë për ndonjë arsye, duke përfshirë mospagesën e premisë. Nëse siguresit do të mund t'u shmangeshin obligimeve në mënyrë retrospektive, atëherë kjo nuk do të mund të ofronte

nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së palës së tretë. Policat duhet të mbeten të vlefshme gjatë 30 ditëve të periudhës së njoftimit, mirëpo anulimi apo ndryshimet mund të jenë efektive pas kësaj.

## **2.4 Vetë-sigurimi**

Ne duhet të miratojmë ndonjë element të vetë-sigurimit të propozuar si pjesë e mbulimit tuaj të sigurisë para se ne të miratojmë licencën. Vetë-sigurimi nënkupton aftësitë tuaja financiare për të përmbushur detyrimet ndaj palës së tretë për të cilën ju nuk keni mbulesë sigurimi. Kjo përfshinë ndonjë tejkalim apo zbritje në polica.

Ju duhet të jeni në gjendje të demonstroi që niveli i vetë-sigurimit është i duhur dhe ju keni aftësinë të plotësoni ndonjë obligim që mund të rrjedhë.

Faktorët që mund të përfshihen janë:

- Një kuantifikim i rrezikut potencial që ka pala e tretë për detyrim.
- Një mbyllje agregate e detyrimeve vetë-siguruese; ju duhet të siguroni një deklaratë të shumës së ofruar në atë mbulim, dëshmitë se mbulimi ekziston që nga data e fillimit dhe hollësitë e ndonjë lloji të humbjeve të cilat mund të mos jenë të mbuluara nga ai mbulim.
- Konfirmimi i mundësisë tuaj për të plotësuar detyrimet tuaja potenciale të vetë-sigurimit, në ndonjë formë: një deklaratë e nënshkruar nga ndonjë drejtor kompanie që vërteton shqyrtimin e detyrimeve potenciale dhe kostoja sipas planit të biznesit të kompanisë, dhe duke konfirmuar një pritje të arsyeshme për plotësimin e detyrimeve të tilla për 12 muaj prej datës së synuar për operim, apo kudo që mendoni se një deklaratë e tillë nuk është e duhur, dëshmi tjera të dispozitave të mjaftueshme sipas marrëveshjes me ne.

Ne nuk caktojmë ndonjë kufi mirëpo shtresat e vetë-sigurimit që janë shumë më lart se normalja në nivelin e tregut mund të jetë i diskutueshëm. Ne rezervojmë të drejtën për të shqyrtuar ndonjë nivel të vetë-sigurimit dhe të kërkojmë nga ju të ndërroni shumat që ndër lidhen me programin tuaj të sigurimit nëse ne besojmë se ata janë të tepruar. Shtresat e vet-sigurimit duhet të jenë të arsyeshme, reale dhe jo të tepruara.

## **2.5 Letrat ndërmjetësuese**

Ne presim nga të gjithë operatorët me obligim sigurimi që të aranzhojnë për ne të marrim konfirmimin se sigurimi adekuat është i rregulluar e cila është në përputhje me miratimin e përgjithshëm.

Ndërmjetësueset e sigurimit duhet të përfshijë emrat e operatorëve që mbulohen nga letra ndërmjetësuese me numrat e kompanisë së tyre. Secila letër ndërmjetësuese duhet të theksojë qartë periudhën e sigurimit që është efektive.

Sikurse me operatorët aktual, ndërmjetësuesi juaj duhet të plotësojë një letër konfirmuese për përmbajtje ndaj miratimit të përgjithshëm, siç është përshkruar më lart.

## **2.6 Ndryshimi i rregullimeve të sigurimit**

Ju gjithashtu duhet të siguroheni që ne njoftohemi nëse ndryshoni ndonjë aranzhim sigurimi. Mos prisni për datat e vazhdimin të sigurimit që të na informoni sa herë që sigurimi juaj ripërtërihet apo ndryshohet. Disa ndërmjetësues mund të preferojnë të dërgojnë konfirmimet me letrën e tyre dhe me logon e tyre.

## **2.7 Aplikuesit e rinj**

Aplikuesit e rinj duhet të na ofrojnë certifikatat e sigurimit. Certifikatat duhet të jenë detyruese, pa marrë parasysh ndryshimet në rrethanat para fillimit apo ripërtëritjes së sigurimit. Secila certifikatë duhet të:

- identifikojë secilin sigurues dhe proporcionin e mbulimit që secili ka marrë tregojnë periudhën e policës
- përmbledhë fushëveprimin e policës dhe secilin prej përjashtimeve,
- dhe të theksojë ligjin qeverisës nën të cilin polica duhet të interpretohet.

## **2.8 Programi i sigurimit që tashmë është miratuar nga ARH**

Nëse programi i sigurimit të cilit i bashkëngjiteni tashmë është miratuar nga ne, atëherë ju prapë duhet të na dërgoni një kopje të certifikatës së ndryshuar ku paraqitet emri i kompanisë suaj. Kjo mund të ndodh për shembull kur një grup tashmë ka disa bartës të licencave të siguruar dhe kompani të reja shtohen në policën e grupit.

## **2.9 Ndryshimet në miratime**

Nëse dëshironi të kërkonte miratim për një lloj apo nivel të mbulimit ndryshe nga mbulimi i miratimit të përgjithshëm ju duhet të dërgoni në një fazë të hershme një rast me argumente të plota për shqyrtim nga ne.

Një kërkesë për ndryshim mund të bëhet në të njëjtën kohë me aplikacionin për licencë.

Të gjitha kërkesat për ndryshim nga miratimi i përgjithshëm duhet të bëhet me shkrim. Ju mund të diskutoni këtë me ne para se të aplikoni.

Kërkesat për ndryshim:

- që normalisht të bëhen në bazë të vlerësimit të rrezikut
- vazhdimi i afateve kohore të aplikacionit të licencës sonë normale.

Ndryshimet e mëdha duke përfshirë të gjitha ndryshimet nga niveli minimal duhet të mbështeten nga vlerësimet e plota të rreziqeve ofruar nga këshilltarët e pavarur zakonisht me përvojë në inxhinierinë e hekurudhave. Një kërkesë për ndryshim duhet gjithashtu të përfshijë informacionet dhe përshkrimin në lidhje me: natyrën, madhësinë, shkallën dhe fushëveprimin e operacioneve fizike dhe kushtet e kontrollit operacional, të mirëmbahet linja hekurudhore, stacionet, planet infrastrukturore dhe e mundshme për ndryshime në bashkëveprim me rrjete tjera, rreziqet e operatorëve dhe palëve tjera të treta, gjasat e tyre për të ndodhur dhe pasojat.

## **ANEKS II: Lista kontrolluese e sigurimit**

Kur të dorëzoni dokumentet në lidhje me rregullimet tuaja të sigurimit për miratim nga ARH, duhet dorëzuar gjithashtu një kopje të listës kontrolluese në vijim, me secilën kuti të shënjuar për të konfirmuar që dokumentet e nevojshme janë siguruar dhe konfirmimi përfundimtar është nënshkruar dhe i është vënë data:

- 1 Certifikatat e sigurimit të nënshkruara nga ndërmjetësi i bartësit të licencës/aplikuesit apo Siguruesi Kryesor për secilën policë përkatëse.
- 2 Secila certifikatë duhet të specifikojë ligjin qeverisës nën të cilin duhet të interpretohet polica.
- 3 Secila certifikatë duhet të identifikojë të gjithë siguruesit dhe proporcionet e tyre.
- 4 Secila certifikatë duhet të specifikojë datën e fillimit të mbulimit dhe datën e skadimit.
- 5 Secila certifikatë duhet të specifikojë Kufirin e Zhdëmtimit që ofrohet dhe nëse është sipas ngjarjeve apo në formë të përmbledhur për policë apo për periudhë tjetër. Nëse ekziston ndonjë limit i përgjithshëm për policën apo ndonjë periudhë tjetër, certifikata duhet të theksojë dispozitat për rivendosje. Nëse nevojitet ndonjë premi shtesë, bartësi i licencës duhet të konfirmojë me një letër të ndarë qëllimin e vet për të paguar premi shtesë kur nevojitet në mënyrë që të mirëmbahet limiti minimal i kërkuar nga ARH. Secila certifikatë në aspektin e kalimit të ndonjë niveli duhet të theksojë pikën e bashkëngjitur.
- 6 Secila certifikatë duhet të përmbledhë fushëveprimin e policës dhe secilin prej përjashtimeve të saj.
- 7 Secila certifikatë duhet të konfirmojë që bartësi i policës bënë mbulimin në baza të “ngjarjeve”.
- 8 Secila certifikatë duhet të konfirmojë që polica e përshkruar ofron në mënyrë specifike që njoftimi 30 ditësh do të jepet tek ARH-ja nga siguruesi për ndonjë ndryshim apo anulim apo për ndonjë ndryshim të rëndësishëm në policë.
- 9 Secila certifikatë duhet të konfirmojë që polica mbulon:
- 10 Bartësin e licencës;
- 11 Punëtorët e vet;
- 12 Dhe ndonjë person tjetër që nevojitet të përfshihet si i siguruar.
- 13 Një shpjegim sa i përket asaj se çfarë hapash ka ndërmarrë bartësi i licencës për të plotësuar kërkesat e veta sa i përket përzgjedhjes së siguruesve të autorizuar në mënyrën e duhur dhe me reputacion të mirë.
- 14 Nëse propozohet vetë-sigurimi me anë të tejkalimit apo mënyra tjera, ofroni dëshmi të aftësisë së licencë mbajtësit që i plotëson këto obligime.
- 15 Konfirmoni datën ku të gjitha kopjet e plota të të gjitha policave do të sillen në ARH (nëse më herët nuk janë parë nga ARH-ja).
- 16 Konfirmimi se ndonjë përjashtim i dëmit të pronës nën përkujdesje, ruajtje dhe kontroll të bartësit të licencës nuk do të vlejë për bagazhin personal të shoqëruar.
- 17 Nëse kërkesat e ARH-së nuk janë plotësuar, duhet ofruar një shpjegim se pse duhet që ARH-ja të aprovojë propozimin alternativ.
- 18 Deklaratat e Drejtorëve për vetë-sigurim.
- 19 Secila certifikatë duhet të konfirmojë që polica e përshkruar nuk përmban përjashtime territoriale e cila nënkupton që ndonjë dispozitë në ndonjë policë nuk është në përputhje me ligjin e ndonjërit prej vendeve në të cilin bartësi i licencës operon apo propozon të operojë dhe nuk përjashton detyrimet nën dispozitat e COTIF-së, Kontrata e Përgjithshme për Përdorim të Vagonëve GCU në gjuhën angleze, CUU në frëngjisht, AVV në gjermanisht, dhe ligje tjera ndërkombëtare relevante.